

RAPORT


I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit BSc në Financë Bankë;

(Anglisht)

Ekspert i vlerësimit të jashtëm:

Prof. Dr.Drini Salko



Korrik 2017

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit BSc në Financë Bankë; (Anglisht)

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Epoka
2	Fakultëti që e ofron	Fakulteti iShkencave Ekonomike dhe Administrative
3	Urdhëri/VKM i licencimit Urdhëri i riorganizimit	VKM Nr 281, datë 12.03.2008 UMASH Nr 312, dt 27.07.2012
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	UMASH Nr 260, dt 07.06.2011 (Bsc Financë/bankë)4 vite))*
5	Titulli i programit të studimit:	Bsc në Financë bankë
6	Cikli i studimit:	Cikli Parë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vitë
8	Kreditët në total (ECTS):	180 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht
11	Programi ofrohet nga institucioni	Universiteti Epoka
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucionë të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 6 (Gjashtë)
16	Aktivizimi i programit të studimit	
17	Numri i Studentëve	195 studentë
	etj	

Shënim:

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e APAAL që ndjekin këtë vlerësim

**Sipas Urdhërit të Akreditimit Nr. 260, datë 07.06.2011, ky program studimi është akredituar si; Bachelor në Financë bankë (me kohëzgjatje normale 4 vite). Është hera e parë që ky program studimi i nënshtohet procesit të akreditimit pas riorganizimit të tij me Urdhër Nr. 312, datë 27.07.2012.*



HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Bachelor në Financë Banke anglisht

- ❖ Me anë të Urdherit Nr. 260, datë 07.06.2011 akreditohet programi **Bsc Financë/Banke (4 vite)** mbeshtetur në VKA Nr. 176, datë 30.05.2011, pozitiv me rekomandime.
- ❖ Me Vendim të Këshillit të Akreditimit Nr. 342, datë 13.07.2012, "Për riorganizimin e programeve të studimit Diplomë I Nivelit të parë DNP në Bachelor të Universitetit EPOKA Financë – bankë, Ekonomiks dhe Administrim Biznesi", ky program studimi miratohet I riorganizuar nga DNP në Bsc Financë Bankë.
- ❖ Me Urdhër Nr. 312, datë 27.07.2012 ky program studimi organizohet në Bsc Financë-Banke (3 vitë), mbeshtetur në VKA Nr. 342, datë 13.07.2012 (vleresim pozitiv me sygjerim).
- ❖ Per programin e riorganizuar **Bsc Financë - Banke (3 vitë)** nuk ka urdher akreditimi.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

1 Prof. Dr Drini Salko

Më 10.07.2017 me shkresë nr 020/11 prot, Universiteti Epoka paraqet pranë ASCAL komente në lidhje me draft RVJ e dërguar në këtë institucion më 27.06.2017. Eksperti I vlerësimit të jashtëm e pa me kujdes komentin e vetëm në lidhje me Pikën 3 "Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit", e pranoi këtë koment duke bërë edhe rregullimin në paragrafin përkatës në Raport. Në këtë mënyrë, ky raport merr formën e tij përfundimtare.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË (BSC Financë- Banke, 4 vitë)

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit Vendim Nr.176 datë; 30.05.2011 për programin e studimit „Financë/bankë“

- a. Të pasurohet literatura në gjuhën shqipe dhe të huaj dhe të bëhet një bashkërendim më i mirë ndërmjet njohurive nga eksperiencia botërore me ato që kanë të bëjnë me realitetin e ekonomisë shqiptare.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

Rekomandimi në lidhje me pasurimin e literaturës në gjuhën shqipe dhe të huaj dhe të bëhet një bashkërendim më i mirë ndërmjet njohurive nga eksperiencia botërore me ato që kanë të bëjnë me realitetin e ekonomisë shqiptare, **është plotësuar.**

ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

Metodologjia e vlerësimit

Realizimi i procesit të vlerësimit të jashtëm u mbështet në një seri dokumentësh dhe kërkesash të ndryshme në lidhje me standardet dhe mënyrën e funksionimit të departamentit. Burim i rëndësishëm për vlerësimin e jashtëm shërbeu raporti i vlerësimit të brendshëm, i cili ishte rezultat i bashkëpunimit ndërmjet stafit akademik dhe atij administrativ dhe pasqyronte situatën e procesit të formimit dhe të zhvillimit në departamentin e Financë Banke. Një rol të rëndësishëm në këtë vlerësim kanë dhe vizitat në vend që u realizuan pranë Universitetit EPOKA, takimet me drejtues të këtij institucioni si shqyrtimi i dokumentacionit bazë mbi të cilën organizohet i gjithë Programi i studimit. Gjatë vizitës në Institucion Eksperti i vlerësimit u shoqërua nga Specialistja e ASCAL, Znj Suela Kromidha

Gjatë vizitës në vend u realizuan takime me drejtues të Institucionit, me drejtues të departamenteve, grupin e vlerësimit të brendshëm, stafin pedagogjik, studentë, sekretarinë mësimore, administratën, arkivin, etj. Gjithashtu u bë vizitë në mjediset mësimdhënëse të këtij Institucioni, në bibliotekën e shkollës, në sallën e kompjuterëve, si dhe u zhvilluan anketime me studentëve të disa grupeve.

Në verifikimin e të dhënave u përdor metoda e marrjes së mostrës, duke nxjerrë në mënyrë të rastësishme kampionët për verifikim. Kjo metodë u përdor në verifikimin e të dhënave lidhur me cilësinë e studentëve, me të dhënat e studentëve në sekretari, me të dhënat për hyrje dhe dalje të studentëve në vite dhe lidhur me frekuentimin e leksioneve dhe të seminareve.

Gjithashtu gjykimi i grupit të punës u mbështet në intervistat e marra nga grupet e ndryshme të interesit (drejtues, grupi i vlerësimit, stafi pedagogjik, studentë, punonjës të administratës, etj).

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kritëret	Vlerësimi sipas standardeve
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kritëri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p> <p>Kritëri 4 Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p>Kritëri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kritëri 6 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Programi I ciklit të parë të studimit Bachelor në "Financë Bankë" bazohet në misionin, qëllimin objektivat e tregut të punës të përcaktuara qartë edhe nga Universiteti "EPOKA" Tiranë. Misioni i këtij program studimi është të arrijë të përgatisë staf potencial të kualifikuar në fushën e financave dhe në sistemin bankar por edhe më gjerë. Njohuritë teorike praktike të fituara nëpërmjet këtij programi do mundësojnë plotësimin e tregut të punës në sektorin bankar dhe financiar në vendin tonë por edhe më gjerë. Këtu kemi parasysh mundësinë e punësimit në kompani të huaja që zhvillojnë veprimtarinë në vendet të tjera të rajonit dhe më gjerë. Studentët e këtij programi synohet të përftojnë njohuritë e nevojshme për tu punësuar brenda dhe jashtë vendit për shkak të formimit teorik, njohurive për ekonominë shqiptare, financën kontabilitetin,</p>

	<p>ligjeve përkatës, dhe njohurive teorike në financë banke.</p> <p>Me përfundimin e programit përkatës synohet që studenti të pajiset me një bashkësi kompetencash si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Aftësia për të parë problemet e përditshme me një këndvështrim më të gjerë, duke përfutuar shprehi të nevojshme që mundësojnë kuptimin e problemeve financiare e bankare dhe të ndërtojnë modele të cilat funksionojnë. • Aftësia për të përdorur teoritë bazë dhe instrumentet financiare për të zgjidhur problemet e shfaqura në fushën financës dhe bankës. • Zotërimi i njohurive në mikroekonomi, makroekonomi, menaxhimit financiar e bankar, dhe metoda matematikore, statistikore dhe ekonometrike në ekonomi.
--	--

Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.

<p>Kritëri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p>Kritëri 2 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p>Kritëri 3 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionësh e specialitetësh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>Programi Bachelor në “Financë Banke” tashmë është në vitin e 3-të zhvillimit të tij. Bazuar në zhvillimet e dy vitëve të fundit Departamenti i Financës pranë Universitetit ka hartuar edhe strategjinë e zhvillimit të këtij programi në kuadër të strategjisë së zhvillimit të institucionit për periudhën 2017-2022. Në strategjinë e paraqitur janë përcaktuar qartë drejtimet e zhvillimi të ardhshëm të këtij programi në fushën akademike dhe shkencore lidhur me përmirësimet në procesin mësimor dhe shkencor. Strategjia përcakton hapat e zhvillimit të mëtejshëm edhe për mundësinë e rritjes me tëj të cilësisë së mësimdhënies, rritjen cilësore të stafit akademik dhe vazhdimësinë e këtij programi në dy nivelet e tjera të programit në fushën e financë bankës. Programi bazohet tashmë në Kartën e Bolonjës që përcakton ndarjen e grupimit të lëndëve në kurrikulën e programit Bachelor në Financë- Bankë, në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira bashkëkohore. Gjithashtu, programi përfshin llojshmëri të gjerë profesionësh e specialitetesh brenda fushës së financë bankës në funksion të qëllimit të tij.</p>
---	---

II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.

<p>Kritëri 1 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kritëri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Financë-Bankë krahas ofrimit për studentët të lëndëve të formimit të përgjithshëm edhe lende të specialitetit të kësaj fushe që kanë edhe karakter praktik me qëllim që studentët të përshtaten me tregun e punës. Ky program është reflektim edhe</p>
--	---

- a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar;
- b. kërkesat e punëdhënësve;
- c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;
- d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionët simotra.

i zhvillimeve intensive në sektorin financiar e bankar në Shqipëri dhe me gjerë qe në thelb bazohen në kërkesat në rritje në tregun e punës në këtë sektor për specialistë të financë bankës. Zhvillimi i këtij programi në gjuhën angleze është një tregues me i mire i faktit të preferencës në shume pozicione punë në këtë sektor të preferencës së specialistëve me njohuri profesionale edhe në gjuhën angleze në financë banke. Njësia e zhvillimit të karrierës pranë Universitetit ka kontribuar jo vetëm në përcaktimin e kuotave të pranimit të deritanishëm të studentëve në këtë program por dhe në planifikimin e këtyre kuotave në të ardhmen. Këto kuota kanë mbajtur parasysh jo vetëm kapacitetin aktual mësimdhënës në Universitet por dhe konkurrencën në tregun e punës në financë banke lidhur me zhvillimet aktuale dhe të ardhshme në këtë treg. Numri i studentëve gjatë 3 vitëve të fundit në këtë program ka pasur një rritje relativisht të rëndësishme nga 52 studentë të regjistruar në vitin 2014 në 80 studentë të regjistruar këtë vit akademik. Mendojmë se ky numër është optimal dhe i arsyeshëm duke pasur parasysh mundësinë e punësimit të një numri të konsiderueshëm të tyre dhe vazhdimin e programit të ciklit të dytë të studimeve në këtë Universitet. Ky numër studentësh është edhe konkurrues në tregun e punës jo vetëm me universitetët e tjera por edhe për faktin se programi i ofruar në anglisht jep përparësi në treg.

Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.

Kritëri 1 Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;
Kritëri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.

Programi Bachelor në Financë Banke në kuadër edhe të programeve të tjera nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe promovon vlerat kulturore kombëtare. Ai është hartuar duke u bazuar në politikat kombëtare të parashikuara në planin strategjik mbi arsimin e lartë të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës. Njëpërmjet aktivitetëve të ndryshme të organizuara nga klubet studentore paraqitën traditat shqiptare edhe tëk numri i vogël i studentëve të huaj që janë të regjistruar në këtë program.

Konkluzionë të GVJ:

Programi Bachelor në Financë-Bankë është bazuar në përputhje me misionin dhe Qëllimin e Universitetit "Epoka". Programi Bachelor në Financë-Bankë po zbatohet në përputhje me planin strategjik të Universitetit "Epoka" si dhe me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar.

Programi Bachelor në Financë-Bankë pajis studentët me njohuritë bazë teorike, shkencor dhe praktike, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme, në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira të edukimit universitar.

Rekomandojmë:

- ❖ *Mendoj se në strategjinë e zhvillimit të këtij programi duhej të kishte objektiva me të garta dhe deri diku eksplishtë lidhur me rritjen e cilësisë të një pjese stafit të Departamentit apo të plotësisht të tij për të realizuar në të ardhmen jo vetëm mundësinë e realizimit të programit të ciklit të tretë të studimit (doktorature) në Financë Banke pranë Institucionit por edhe realizimin e këtij objekti pranë Universiteteve jashtë vendit. Kjo do të bënte që në vitet e ardhshme të kemi një hop me cilësor të stafit për t'ju përgjigjur objektivave afatmesme të Institucionit*

2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

Programi Bachelor në Financë Banke zhvillohet nga Departamenti Financë Banke që është një nga tre departamentet e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative pranë Universitetit "Epoka"

Organi me i lartë vendimmarrës është Këshilli i Lartë i Universitetit. Mbështetur në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative është njësis kryesore e Universitetit "Epoka" që bashkërendon mësimdhënien, kërkimin shkencor nëpërmjet programeve të studimeve të llojeve dhe niveleve të ndryshme. Organet dhe autoritetet drejtuese të Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative janë: Dekani, Zëvendës dekani, Kancelari, Bordi i Fakultetit dhe Bordi Administrativ i Tij. Departamenti Financë Banke është njësis bazë mësimore-kërkimore, që përfshin fushën e kërkimit në Financë, kontabilitet dhe bankë duke përfshirë këto disiplina përkatëse.

Parë në tërësi, mund të themi se kemi zbatim hierarkik të strukturës Universitare dhe asaj të Fakultetit dhe departamentit me organe të përcaktuara qartë që mbulojnë fushën e kërkimit shkencor, mësimdhënies dhe atë administrative. Në të gjitha nivelet përkatëse kemi organe të zgjedhura të cilat e bazojnë operimin dhe kompetencën e tyre bazuar në rregulloret përkatëse.

Bazuar në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm mendojmë që në këtë hierarki duhet pasur parasysh si më poshtë:

Së pari; Roli i Këshillit të Profesorëve të Fakultetit na jepet me shumë kompetenca në raportin e Vlerësimit të Brendshëm, në një kohë që bazuar në Ligjin e Ri të Arsimit të Lartë 80/2015 ky organ zbehet apo nuk ekziston si strukturë.

Së dyti, në raport nuk del e qartë roli i Departamentit si përgatitës dhe propozues për hapjen e programeve të reja të studimit.

3. Personëli akademik dhe personëli mbështetës për programin e studimit

Stafi akademik i që i përket Departamentit të Financë Banke i angazhuar në këtë program studimi përbëhet nga 16 anëtarë përfshirë dhe ndihmësin akademik, pra 15 pedagogë nga të cilët 7 janë të brendshëm (që përbejnë dhe numrin minimal për një Departament) dhe 8 janë të jashtëm. Për zhvillimin e këtij programi janë angazhuar edhe pedagogë të departamenteve të tjera që mbulojnë lëndët e formimit të përgjithshëm dhe aplikativ që i përkasin këtyre departamenteve të tjera. Kështu, numri totali i stafit akademik që zhvillojnë të gjitha lëndët e këtij programi është 27 pedagogë, nga të cilët 16 janë Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe 11 pedagogë që janë Personel Akademik me Kontratë (PAK). Bazuar sa me sipër rezultojnë që:

Raporti Personel Akademik / Student është $27/195=0.14$

Raporti Personel Administrativ / Student është $4/195= 0.02$

Raporti PAE/PAK në këtë program është $16/11 = 1.45$

Raporti PAE/Totalit të personelit akademik $16/27 = 60 \%$

Raporti pedagog të përfshirë në zhvillimin e këtij programi/ student për këtë program është optimal 1 pedagog për 7.2 studentë të regjistruar, që përfaqëson një nivel normal.

Bazuar në raportet e mësipërme, vihet re ky program mbulohet në një pjesë të madhe rreth 60 % nga staf i brendshëm dhe rreth 40 % staf i jashtëm, ose me kohë të pjesshme.

Raportët e dhëna mësipërm janë të mjaftueshme për numrin e studentëve aktualë të këtij programi.

Duke vlerësuar stafin akademik të përfshirë në këtë program vëmë re se nga numri total prej 27 pedagogesh; vetëm 1 zotëron titullin Prof.Dr; si PAE; 5 pedagogë zotërojnë titullin akademik Prof.asoc.Dr. nga të cilët 3 janë PAE; 8 pedagoge zotërojnë Gradën shkencore Doktor nga të cilët 7 janë PAE; 13 pedagoge janë pa grada shkencore apo tituj akademik ku vetëm 3 prej tyre janë PAE.

Shihet që në total pedagogoet pa grada shkencore dhe tituj akademik zënë rreth 48 % të personelit të angazhuar në këtë program, ndërsa pesha e pedagogëve që janë PAE pa grada shkencore dhe tituj akademik zë rreth 31 % të stafit PAE.

Kritëret e rekrutimit të personelit akademik janë në varësi të kërkesës për staf akademik. Preferohen për t'u zgjedhur stafi akademik me grada e tituj. Nga këta, më të preferuarit janë ata të diplomuar në vende të zhvilluara. Rëndësi i jepet edhe përvojës së stafit që pritet të merret në punë.

Në lidhje me punësimin e stafit akademik në verifikuam praktikën e ndjekur që nga shpallja e vendit vakant deri në emërimin e kandidatit nga organet përkatëse. Kjo praktikë është konform rregullave të paravendosura nga organet përgjegjëse të Burimeve Njerëzore dhe Bordit përkatës. Pas leximit të kontratës, stafi akademik e nënshkruan atë dhe Zyra e Financës siguron nënshkrimin e kontratës nga Rektori i Universitetit "Epoka" si edhe vulosjen e saj.

Mbledhja e të dhënave të stafit bëhet nga një formë e cila quhet "Të dhënat individuale të stafit" ku çdo personël i ri hedh të dhënat e tij personale. Kjo formë qëndron në dosjen personale të çdo pjesëtari të stafit dhe të dhënat e tij gjithashtu hidhen në sistemin e Universitetit (EIS) me akses vetëm nga Zyra e Burimeve Njerëzore.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kritëret	Përmbushja e standardeve
III - PERSONËLI I INSTITUCIONIT	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparentë të rekrutimit dhe vlerësimin të personelit.	
<p>Kritëri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparentë të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kritëri 2 Personëli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kritëri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparentë të vlerësimin të personelit;</p> <p>Kritëri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raportëve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>Rekrutimi i stafit akademik bazohet në kërkesat e Departamentëve përkatëse. Zyra Burimeve Njerëzore ndjek gjithë procesin e njoftimit, përpilimit të dokumentacionit të kandidatëve për rekrutim dhe kalimin e këtij dokumentacioni Bordit Administrativ të Fakultetit. Vlerësimi realizohet nëpërmjet Komisionit prej tre akademikësh ku realizohet edhe intervista me ta. Bordi Administrativ i Fakultetit analizon këtë raport dhe vendimin e tij ja dërgon për shqyrtimin e miratim Bordit Administrativ të Universitetit. Ky i fundit pasi e shqyrton vendimin, ia transmeton atë Këshillit të Lartë të Universitetit i cili jep vendimin përfundimtar.</p> <p>Pas vendimit përfundimtar nga ana e Këshillit të Lartë të Universitetit, kandidati plotëson</p>

dokumentet e kërkuar nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe nënshkruan kontratën e tij pas deklarimit në organet tatimore.

Stafi akademik i angazhuar në programin "Bachelor në Financë-Bankë" përbëhet prej gjashtëmbëdhjetë pjesëtarësh si PAE dhe njëmbëdhjetë pjesëtarë si PAK. me kohë të pjesshme.

Numri i PAE ndaj numrit total të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi përbën afro 60%, ndërsa ngarkesa akademike e realizuar nga PAE është 67% (nga 70 % që është kriteri minimal i standardit) të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit Financë Banke të studimeve të ciklit të parë;

Bazuar në Rregulloren e Punësimit dhe Vlerësimit të Performancës Akademike të miratuar nga Senati, Institucioni e plotëson këtë kriter dhe procedurë bazuar në kriteret ligjore dhe transparente të Universitetit. Në evidentuam vlerësime të stafit akademik nga anketimet e realizuara nga studentët për ta si dhe vlerësime të veprimtarisë së tyre mësimore dhe shkencore të lidhura me botimet e tyre.

Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personëlin e tij.

Kritëri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;

Kritëri 2 Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;

Kritëri 3 Institucioni publikon kritëret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;

Kritëri 4 Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personël akademik që ka së paku gradën shkencore "Doktor, ose titullin akademik "Docent,,".

Zyra e Burimeve Njerëzore disponon të gjithë të dhënat e hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program të cilat i ka të hedhura në sistemin interaktiv të Universitetit (EIS) Në verifikuam që këto të dhëna përfshinin informacione personale, eksperiencën e mëparshme etj.

Ne verifikuam listën e plotë të personelit akademik të përfshirë në programin "Bachelor në Financë-Bankë" të Departamentit të Financë-Bankës.

Lidhur me rekrutimin e personelit akademik në verifikuam procedurat përkatëse të cilat fillonin që me njoftimin e vendit vacant, kriteret përkatëse vlerësimin përzgjedhjen dhe miratimin e tyre deri në nënshkrimin e kontratës. Këto procedura janë të plota.

Universiteti "Epoka" përgjithësisht ka angazhuar si titullarë të lëndëve për programin e studimit Bachelor në Financë-Bankës personel akademik që ka së paku gradën shkencore Doktor.

"Doktor" janë vetëm 7 pedagogë që nuk e kanë gradën Doktor por që zotërojnë Diplomën Mastër i Shkencave që zhvillojnë lëndët në këtë program. Pozitive është fakti që pothuajse të gjithë këta pedagogë pa gradën shkencore Doktor zhvillojnë lëndë të karakterit të përgjithshëm si Gjuhë e huaj, etj)

Standardi III.3 - Institucioni angazhon personël ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.

Kritëri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;

Kritëri 2 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;

Kritëri 3 Institucioni vë në dispozicion personël të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).

Universiteti "Epoka" angazhon asistentët kërkimorë si personel ndihmës kërkimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe mirë përdorimin e ambienteve laboratorike që ndodhen në mjediset shkollore. Kështu programi Bachelor në Financë-Bankë i përdor laboratorët vetëm gjatë zhvillimit të lëndës së "Ekonometrisë Financiare".

Angazhimi i 27 pedagogeve në këtë program të stafit akademik me kualifikimet e nevojshme akademike si dhe ngarkesës mësimore përkatëse të mbuluar nga anëtarët e stafit akademik dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore nga Universiteti "Epoka" për përmbushjen e objektivave të programit të studimit.

Studentët në programin e studimit Bachelor në Financë- Bankë anglisht nuk kanë detyrim kryerjen e praktikës profesionale

Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtëjshëm të personelit të tij.

Kritëri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtëjshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;

Kritëri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.

Në evidentuam organizimin nga Universiteti "EPOKA" e trajnimeve për stafin tij në disa drejtime. Programet e trajnimit përfshinin fusha si Classroom Technologies, Moodle, Turnitin, Sistemin EIS, etj. Njëkohësisht, Universiteti "Epoka" publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik në faqen zyrtare: hr."Epoka".edu.al

Kabineti i Rektorit, sekretaria mësimore si dhe sekretaritet e secilit program disponojnë bazën e të dhënave të programeve të studimeve të ofruara nga Universiteti "Epoka".

Konkluzionë të GVJ:

Në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, programi Financë Banke mbulohet nga njësia bazë mësimore shkencore që është Departamenti Financë Banke me një PAE prej 7 pedagogesh dhe 1 asistent aq sa është edhe minimumi i kërkesës ligjore si dhe 9 pedagogë si PAK. Në zhvillimin e këtij programi janë të angazhuar 27 pedagogë nga të cilët 16 si PAE dhe 11 si PAK.

Bazuar në kuadrin e brendshëm rregullti në Universitetin Epoka" zbatohen kriteret të qarta dhe transparente lidhur me rekrutimin e punonjësve të rinj.

Për të gjithë personelin akademik të angazhuar në procesin e mësimdhënies, PAE dhe PAK ekziston dokumentacion i plotë dhe i arkivuar nga Zyra e Punës, përfshirë këtu edhe CV individuale të detajuar. Informacioni freskohet çdo vitë bazuar në raportin vjetor të aktivitetit. Baza e të dhënave për PAE dhe PAK si dhe personelin ndihmës dhe administrative është e sistëmuar Universiteti "Epoka" angazhon si titullarë të lëndëve për programin e studimit Bachelor në Financë-Bankë kryesisht personel akademik që ka së paku gradën shkencore "Doktor" . Titullarët e lëndëve që nuk kanë gradën shkencore "Doktor", kanë përfunduar programet e studimit të ciklit të dytë Mastër i Shkencave ose programe të barasvlershme me to dhe njëkohësisht, vijnë studimet e Doktoratës.

Universiteti "Epoka" siguron zhvillimin në një bazë të rregullt të programeve dhe eminareve trajnuese për të gjithë personelin akademik dhe administrativ.

Rekomandime:

- *Universiteti "Epoka" duhet ti paraprijë ndryshimeve apo rregullimeve të ardhshme në currikulën e programit Financë Bankë anglisht si dhe rritjes së ngarkesës mësimore të pedagogeve të Departamentit në këtë program. Për këtë është e nevojshme të rritet numri*

i PAE me titull akademik apo gradë shkencore. Kjo për faktin se numri e PAK është relativisht i lartë.

- *Numri i PAE në Departamentin e Financë Bankë pa titull akademik dhe gradë shkencore është i lartë (4 pedagoge nga 7 gjithsej). Prandaj Universiteti në kuadër të rekrutimeve të reja duhet të synojë rregullimin e këtij raporti, si dhe të nxisë dhe përshpejtojë marrjen e gradave shkencore nga PAE aktual.*
- *Numri i PAE ndaj numrit total të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi përbën afro 60%, ndërsa ngarkesa akademike e realizuar nga PAE është 67% (nga 70 % që është kriteri minimal i standardit) të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit Financë Banke të studimeve të ciklit të parë;*

4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Universiteti “Epoka” duhet konsideruar si një nga universitetët e pakta në Shqipëri që operon në kushtet e një kampusi të vërtetë universitar I cili duhet thënë se është rritur dhe plotësuar gjatë viteve të fundit. Infrastruktura mësimore, shkencore, dhe e shërbimeve të tjera ndihmese në funksion të realizimit të misionit të Universitetit duhet vlerësuar bashkëkohor dhe që ofron komoditet në procesin mësimor, shkencor dhe të shërbimit. Krahas ambienteve komode të zhvillimit të mësimit në dy godinat kryesore të kampusit universitar ka dhe shume ambiente në shërbim të mësimit si bibliotekë, sallë interneti, mjedise për Këshillin si dhe ambiente çlodhëse për studentët si mensë, kafeteri, dhe klubet studentore, mjedise sportive etj.

Nga vizita pranë bibliotekës së Universitetit “Epoka” evidentuam fondin të pasur të librave në gjuhë të ndryshme të ofruara për studentët dhe stafin akademik si dhe kapacitetin e mjaftueshëm prej afro 70 vendesh që ajo ka.

Në evidentuam dhe pasurimin e fondit të bibliotekës gjatë viteve të fundit me literaturë bashkohore. Lidhur me programin Financë Banke në bibliotekë ofroheshin tekste ndërkombëtare në anglisht për disiplinat kryesore në fushën e financës dhe bankës. Biblioteka ofron dhe fondin online duke u dhënë akses studentëve dhe stafit akademik për të shfrytëzuar literaturë nëpërmjet burimeve elektronike pa pagesë.

Universiteti ofron shërbime të tjera për studentët nëpërmjet mensës të vendosur në mjediset e godinës universitare, shërbime kancelarie etj.

Universiteti ofron edhe disa shërbime të tjera kryesisht elektronike (programe kompjuterike dhe eëbsitë të krijuara) në ndihmë të procesit mësimor, lehtësisë në marrjen e informacionit dhe transparencën e tij. Të tilla shërbime janë ; *Ëebmail; “Epoka” Intëreactive Systëm (EIS); Education Information Systëm (Curriculum); Learning Management Systëm (LMS); Google Classroom; Library Automation Systëm ; etj*

Gjatë vitit akademik 2016-2017, në Kampusin e Universitetit “Epoka” janë në funksion të zhvillimit të mësimit 16 klasa, 4 salla leksionësh, një sallë konferencash, dy laboratorë kompjuterash, 2 salla internet, si dhe internet wireless në të gjithë hapësirën e tij.

Laboratorët e informatikës janë në shërbim të lëndëve përkatëse të zhvilluara në programin Financë Banke dhe sidomos përdorimi i tyre edhe për lëndën e “Ekonometrisë Financiare”, që është një lëndë bashkëkohore për këtë program.

Nga vizita në ambientet e universitetit në evidentuam mjedise komode për stafin akademik dhe administrativ. Zyrat përkatëse për drejtuesit akademik dhe administrativ si dhe për personelin akademik ishin komode dhe të pajisura mire për një efikasitet të punës së stafit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kritëret	Përmbushja e standardeve
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTËKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI	
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kritëri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tëkëtë mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p>Kritëri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kritëri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kritëri 4 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p>Kritëri 5 Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Universiteti “Epoka” ka vënë në dispozicion të programit Financë Banke tekstet bazë dhe literature ndihmëse e cila gjendet në mjediset e bibliotekës së Universitetit. Kjo literaturë është bashkëkohore dhe pasqyrohet shumë më mirë në syllabuset përkatëse të secilës lëndë mësimore. Tëkstët baze janë kryesisht tëkstët studentore ndërkombëtare të botimeve të viteve të fundit.</p> <p>Biblioteka e Universitetit “Epoka” ka një fond të pasur me libra në fushat përkatëse të programit Financë Bankë. Librat që ndodhen në bibliotekë janë të inventarizuar dhe të klasifikuar sipas metodologjisë Bibliotekës së Kongresit (LCC). Fondi i Bibliotekës është ngritur në përputhje me nevojat dhe kërkesat e studentëve dhe stafit akademik e administrativ.</p> <p>Universiteti “Epoka” është i abonuar në bazën e të dhënave JSTOR e cila i mundëson stafit dhe studentëve të Universitetit aksesin në një gamë mjaft të gjerë të revistave shkencore. Përmes këtij fondi online, ofrohet aksesin në mbi 2000 revista akademike të burimeve elektronike me tëkst të plotë me cilësi të lartë është i disponueshëm pa pagesë për stafin, studentët dhe përdoruesit e bibliotekës.</p> <p>Fondi i pasur i botimeve periodike dhe bibliotekës elektronike i ofron studentëve të programit të studimit Bachelor në Financë dhe Bankë të gjitha mundësitë për përmbushjen me sukses të kërkesave të programit të studimit si dhe për kryerjen e hulumtimeve të ndryshme në lidhje me përgatitjen e detyrave, projektëve, tëmave të diplomimit etj.</p> <p>Para fillimit të çdo viti akademik, përgjegjësi i programit të studimit harton një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit duke përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim</p> <p>Oraret e punës të bibliotekës janë të shpallura në faqen eeb të Universitetit. Ato janë të shfaqura edhe në hyrje të bibliotekës, e cila është e hapur për studentët nga e Hëna deri të Shtunën</p>
Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedisë të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.	
<p>Kritëri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedisë të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së</p>	<p>Universiteti “Epoka” zotëron hapësira të mjaftueshme dhe bashkëkohore në procesin mësimor dhe shkencor nëpërmjet laboratorëve të kompletuar mirë, klasa, zyra, salla</p>

informacionit, për realizimin e programit të studimeve;

Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;

Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetët e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;

Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.

Kriteri 5 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutëra në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programestimulimi për shkencat sociale etj.

Kriteri 6 Institucioni garanton, me kapacitetët që zotëron ose në bashkëpunim me institucionë dhe subjektë të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.

konferencash, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve.

Klasat dhe auditorët janë të pajisur me të gjithë infrastrukturën e nevojshme për ushtrimin e një procesi mësimor sa më efektiv. Gjithashtu, mjediset janë të kompletuara me sistem kondicionimi, kompjuter, projektor, tabelë interaktive (smart board), internet, karrige ortopedike etj.

Për të bërë të mundur një mësimdhënie sa më efektive dhe për t'u ardhur në ndihmë studentëve, universiteti ka instaluar programe kompjuterike që i shërbejnë drejtpërdrejt këtij programi si Financë 5 në kontabilitet apo programi Evieës, i përdorshëm në lenden e ekonometrinë financiare ,statistikes etj.

Mjediset e kompletuara bëjnë të mundur që studentët të marrin jo vetëm njohuritë teorike shkencore por edhe ato aplikative dhe praktike.

Konkluzionë të GVJ:

Universiteti "Epoka" me infrastrukturën mësimore, shkencore, administrative dhe të shërbimeve mund të konsiderohet në këtë drejtim si një kampus universitar i plotë. Në funksion të kësaj, zhvillimi I programit Financë Banke në anglisht realizohet në kushtet e hapësirave të mjaftueshme dhe bashkëkohore lidhur me laboratorët mësimor, klasa, zyrat e personëlit, salla konferencash, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve. Këto ambiente janë të pajisur me të gjithë infrastrukturën e nevojshme për ushtrimin e një procesi mësimor sa më efektiv. Studentët e programit Bachelor në Financë Bankë i përdorin laboratorët kompjuterikë gjatë procesit të mësim nxënies në zhvillimin e lëndës profesionale në financë dhe kontabilitet.

Rekomandim:

Meqenëse studentët në programin e studimit Bachelor në Financë Bankë nuk e kanë të Detyruar (pra në programin e miratuar dhe që po zhvillohet) kryerjen e praktikës profesionale, Universiteti "Epoka" duhet të garantojë për të gjithë studentët realizimin e praktikave profesionale pranë institucioneve (kryesisht financiare) apo kompanive të ndryshme. Ky proces deri tani realizohet në kuadër të marrëdhënieve që ka universiteti me këto subjekte, ose mundësive që kanë studentët për të kryer praktika jashtë periudhës së zhvillimit të programit. Për një realizim me të mire të këtij objekti të rëndësishëm mendojmë se përfshirja në programin e Financë Bankës të praktikës profesionale pranë institucioneve financiare apo kompanive të ndryshme do të realizojë plotësisht këtë komponent të këtij programi.

Në përfundim GVJ konkludon që infrastruktura në funksion të programeve të studimit, Financë Banke në anglisht, logjistika dhe shërbime të tjera për studentët dhe stafin akademik e ndihmës i përmbushin plotësisht kritëret.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Të ardhurat kryesore të institucionit sigurohet nga pagesat e tarifave të studentëve. Universiteti kalkulon koston e parashikuar për student si dhe shpenzimet përkatëse.

Nga shqyrtimi financiar i dokumentëve të kryer nga vetë Universiteti "EPOKA" rezulton se të ardhurat mesatare për student për vitin akademik 2015-2016 janë 1.846 euro, ndërsa shpenzimet mesatare për student për këtë vit akademik janë 1.342 euro.

Procesi financiar dhe kontabël i nënshtrohet sipas akteve ligjore dhe nënligjore procesit të auditimit të jashtëm.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kritëret	Përmbushja e standardeve
<p>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij; Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj; Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të grantëve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Çdo vit, Shoqëria Turgut Ozal Education sh. a. i nënshtrohet auditimit të jashtëm për sa i përket situatës financiare dhe ky raport ruhet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të shoqërisë . Në raportin e auditit paraqiten të gjitha të dhënat mbi shpenzimet dhe të ardhurat që ka shoqëria Brenda raportit janë të specifikuara të gjitha zërat në lidhje me të ardhurat si: grantet, taksat studentore etj. dhe të gjitha shpenzimet për shërbimet që ofron në mënyrë direkte apo indirekte (nga kompani të treta – outsourcing).</p>
<p>VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostovë të programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë tëhollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributëve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare; Kriteri 2 Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike; Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitetë financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenërimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Raporti financiar hartohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shoqërisë çdo vit dhe arkivohet pranë kësaj drejtorie. Pas përfundimit të raportit, Universitetit “Epoka” i komunikohen të dhënat e paraqitura. Universiteti “Epoka” i referohet buxhetit të përgjithshëm të kompanisë si institucion në varësi. Raportet financiare të tre viteve të kaluara akademike janë të disponueshme në çdo kohë në Zyrën e Financës së Universitetit “Epoka” Duke iu referuar raportit financiar zyrtar të Shoqërisë Turgut Ozal Education sh. a., kompania ka një bilanc vjetor pozitiv, qw duhet konsideruar pozitive lidhur me garantimin e ecurinë sw Universitetit “Epoka” në tërësi dhe programit Financë Banke në veçanti..</p>
<p>Konkluzionë të GVJ: Nga evidentimi formal I dokumentacionit ekonomik financiar, Shoqëria Turgut Ozal Education sh. a., pjesë e së cilës është edhe Universiteti “Epoka”, harton raportin financiar që përmban të detajuar gjendjen financiare lidhur me të ardhurat shpenzimet dhe rezultatin financiar. Çdo vit, Shoqëria Turgut Ozal Education sh. a. i nënshtrohet auditimit të jashtëm për sa i përket situatës financiare dhe ky raport ruhet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të shoqërisë Duke iu referuar raportit financiar zyrtar të Shoqërisë Turgut Ozal Education sh. a., kompania ka një bilanc vjetor pozitiv, i cili garanton ecurinë e Universitetit “Epoka”. Duke iu referuar raportit financiar zyrtar të Shoqërisë Turgut Ozal Education sh. a., kompania ka një bilanc vjetor pozitiv, qw duhet konsideruar pozitive lidhur me garantimin e ecurinë sw Universitetit “Epoka” në tërësi dhe programit Financë Banke në veçanti. GVJ konstaton se mbështetur në treguesit e dokumentacionit ekonomik dhe financiar, Institucioni i përmbush kriteret ekonomik financiare dhe të procedurave lidhur me to bazuar në aspektet ligjore dhe nënligjore të lidhura me këtë proces.</p>	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Bazuar në legjislacionin shqiptar mbi arsimin e lartë dhe udhëzimit të të Universitetit “Epoka”, “Për vlerësimin akademik dhe përmirësimin e cilësisë” në institucion është ngritur Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë. Njësia Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) e këtij sistemi është Këshilli i Vlerësimit Akademik dhe Zhvillimit të Cilësisë (KVAZHC) I cila ka detyra dhe funksione të percaktuara qartë në kryerjen e gjithë procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë.

Numri i anëtarëve të KVAZHC-së dhe zgjedhja e tyre realizohet nga Senati i Universitetit bazuar në vendimet përkatëse të Senatit. Udhëzimi i mësipërm i është nënshtruar edhe amendimeve rrjedhojë Manualit të Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë në Institucionet e Arsimit të Lartë, miratuar në tetor 2012 nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL), Në bazë të këtyre amendamentëve, është bërë edhe rithemelimi i KVAZHC-së nëpërmjet Vendimit Nr. 1, datë 22.04.2013 të Senatit Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë realizohet nëpërmjet disa mënyrave dhe teknikave të percaktuara edhe nga APPAL si,

- anketimeve me studentët,
- hartimin e raportëve të vetëvlerësimit;
- adutimin e brendshëm lidhur me kontrollin e brendshëm të cilësisë
- Pjesëmarrja e titullarëve të institucionin gjatë procesit mësimor etj.

NJSBC aktualisht ka 8 anëtarë

Në fund të semestrit përkatës NJSBC- realizon anketimin nëpërmjet sistemit elektronik vlerësimin me të gjithë studentët e programit Financë Banke qe në total është 195 anketime për të tre kurse dhe qe vlerësojnë çdo lende të zhvilluar gjatë vitit akademik. Anketimet përpunohen dhe hartohet raporti përkatës me vlerësimet e studentëve.

Nga ana tjetër shumë nga takimi me studentët në morëm komentë pozitive të tyre qe konfirmojnë të njëjtën gjë, më konkretisht: Stafi akademik shumë i mire e i kualifikuar, komunikim i afërt me pedagogët, metoda dhe teknologji të mira të mësimdhënies, literatura shumë e mire, ndihma personale si konsultimet sa herë që studentët dëshirojnë nga stafi akademik, mundësinë që diploma të njihet jashtë vendit, sistemi shumë të mirë i bursave dhe studentët që nuk kalojnë testin për shkak të nivelit jo të duhur të anglishtës universiteti ju ofron kurse intënsive dhe më pas bëhet përsëri testi i pranimit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kritëret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumentë matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.	
Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumentë matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve; Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional; Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatët e pritshme, rezultatët e vlerësimit dhe rezultatët që synon të arrijë; Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta: Të tërthorta:	KVAZHC-ja si NJSBC se Universitetit “Epoka” drejton gjithë procesin e sigurimit të cilësisë. Kjo njësi ka akses të plotë informacioni rreth rezultatëve të vlerësimit nga studentët dhe stafi. Raporti I vetëvlerësimit si nje sinteze e sigurimit të cilësisë është baze edhe për ndryshimet në programet studimore. Në këtë raport është bazuar edhe gjithë ndryshimi që është bere në programin financë banke në anglisht duke I transformuar në një program Bachelor me periudhe 3 vjeçare dhe 180

- a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve;
- b. Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit;
- c. Pyetje konceptuale;
- d. Intërvista;
- e. Etj.

Të drejtpërdrejta:

- a. Tëstë të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionët e rregulluara);
- b. Dëgjime në auditor;
- c. Vlerësimi me nota/pikë;
- d. Tëstime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;
- e. Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatët);
- f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;
- g. Etj.

kreditë. Janë përdorur metoda indirekte dhe direkte të vlerësimit.

Metodat indirekte të vlerësimit janë zbatuar me anë të anketës së zhvilluar me studentë përfshihen aspektë të vlerësimit të lendeve , cilësisë së mësimdhënies për pedagogun dhe rekomandime nga studentët, elementë këto të rëndësishëm për sigurimin e cilësisë.

Metoda direkte janë ato të përfshira edhe në syllabus-in e lëndës lidhur me vlerësim me pikë për aktivizimin në auditor; vlerësim të detyrave të kryera nga studentët; vlerësim për përfshirjen në aktivitetë jashtë shkollore;

Gjithashtu janë realizuar dëgjime të drejtpërdrejta nga titullarët e Universitetit në auditor për lende të ndryshme.

Vlerësimet nëpërmjet teknikave të lartpërmendura që sintetizohen në raportin përkatës bëhen publike.

Një rendësi i jepet angazhimit të studentit gjatë vitit sidomos prezantimit të detyrave të kurseve të përgatitura dhe prezantuar në auditor.

VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË

Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentët e duhura për sigurimin e cilësisë;

Kriteri 3 Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;

Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;

Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

Universiteti "Epoka" është I akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programit të studimit Financë Banke anglisht.

Ky program studimor që nga viti 2012 I është nënshtruar ndryshimeve apo rregullimeve të ndryshme duke u bazuar edhe nga vlerësimet nga personeli akademik dhe studentët duke arritur të sigurojë e caktuara. Ka patur jo vetëm rregullime në brenditë e lëndëve por edhe në futjen e lëndëve të reja në program bazuar në procedurat e miratimit nga strukturat përgjegjëse si Departamenti e me radhë.

Metodat indirekte të vlerësimit janë implementuar me anë të anketës së zhvilluar me studentë ku ka patur seksionë të veçanta lidhur me përmbajtjen e lendeve, performance e pedagogut, shërbimet lehtësuese në mësimdhënie dhe mesimnxenie etj

Metoda direkte në i pamë në komponentët e syllabusve lidhur me vlerësimin me pikë dhe notë për elementët e mesimnxënies Ndërgjegjësimi I personelit dhe studentëve lidhur me cilësinë plotësohet edhe nëpërmjet guidave studentore dhe të stafit

ku merret informacioni e plotë lidhur me sigurimin e cilësisë mësimore dhe shkencore. Në funksion të këtij objekti në Universitet janë realizuar trajnime për studentët dhe stafin nga specialitet njohëse më të mire të kësaj fushe. Universiteti "Epoka" ka hartuar dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar në planin strategjik të institucionit.

Konkluzionë të GVJ:

KVAZHC) përbën NJSBC se Universitetit "Epoka" të Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. KVAZHC, vlerëson periodikisht treguesit e veprimtarive mësimore, kërkimore dhe administrative të Universitetit, duke përdorur metoda të drejtë dhe indirektë të vlerësimit.

Bazuar në shqyrtimet e detajuara dhe verifikimeve në terren, konstatohet se Universiteti nëpërmjet NJSBC-se dhe organeve të tjera vendimmarrës duke filluar nga Departamenti i Financë Bankës dhe deri të Senati i Universitetit kanë përdorur instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herë pas herëshme të programit Financë Banke anglisht bazuar edhe në strategjinë për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë që ka hartuar institucioni

GVJ konstaton se programi Financë Banke në anglisht i përmbush kritëret e kërkuara të sigurimit të cilësisë.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Programi i studimeve Bachelor në **Financë-Bankë anglisht** i Universitetit "Epoka" ofrohet nga Departamenti i **Financë-Bankë** i cili është pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative.

Misioni i Programit Bachelor në Financë-Bankë anglisht është përgatitja e studentëve me njohuritë teorike, profesionale dhe shkencore në fushën e financave publike e privatë si dhe të industrisë bankare dhe financiare.

Në funksion të këtij misioni, objekti kryesor i programit të Financë-Bankës është të pajisë studentët me njohuri të plota në fushën e financës dhe bankave. Duke njohur tregun e punës në këtë fushe të diplomuarit e Departamentit të Financë- Bankës në këtë program kanë mundësi të mëdha për punësim në institucionët financiare privatë dhe publike si dhe në hallkat e tjera të Sistemit Financiar shqiptar por dhe me gjerë. Në zhvillimin e programit Financë Banke ofrohen teknikat bashkekohore të mësimdhënies, si laboratorë kompjuteri, lidhje intërnëti dhe një bibliotekë të pasur me burimet të pasura literature.

Objektiva të tjera të programit Bachelor në Financë-Bankë anglisht konsistojnë edhe në :

- Përfitim të aftësive praktike për të kuptuar problemet e riskut në sektorin bankar dhe financiar.
- Përfitim të njohurive tëorike dhe shkencore lidhur me financat dhe bankat, tregjeve të tyre dhe analizës së performancës dhe veprimtarisë bankare.
- Aftësimin e studentëve në përdorimin e programeve kompjuterike në përdorimin zyrtar të përditshëm dhe për vlerësimin e të dhënave statistikore në departamentët e bankave dhe financave.

- ❖ Programi i studimeve Bachelor në “Financë Banke” ka startur në vitin akademik 2012-2013 qe realizon ;
- 180 ECTS, në përputhje me planin mësimor të propozuar nga Departamenti i Financë Banke, me vendim Bordit të Fakultetit dhe miratuar me vendim të Senatit Akademik të Universitetit “Epoka”.
- 1 vit akademik ka 32 javë mësimore në auditor, përfshirë edhe javën e provimeve.
- 1 Semestër ka 16 javë mësimore në auditor, përfshirë edhe javën e provimeve.
- 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit.
- 1 orë mësimore = 60 minuta.
- Studenti realizon çdo vit jo më pak se 1500 orë punë.
- Një vit akademik ka 60 ECTS.

❖ Emërtimi i diplomës për programin Financë-Bankë
 Departamenti i Financë-Bankës ofron për studentët ketë programe studime Bachelor ku në fund studentët pajisen me titullin “Bachelor në Financë-Bankë (Anglisht)” Në planet mësimore të jepet ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë.

❖ Planët mësimore për programet e studimit

Në RVB të Universitetit “Epoka” jepet i plotë plani mësimor i detajuar sipas numrit të lendeve për semestër qe është 6, lendet me zgjedhe qe fillojnë të zhvillohen qe në vitin e dytë të programit, numri I kreditëve përkatëse etj. semestrave, numrit të lendeve

❖ Mënyra e përcaktimit të kreditëve (ECTS) për format e studimit:

- Për leksionët 1846 orë në auditor dhe 2654 orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret 64 orë në auditor dhe 11 orë punë e pavarur e studentit
- Për Laboratorët 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën lëndore 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën Profesionale 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar 2 orë në auditor dhe 18 orë punë e pavarur e studentit

Planet mësimore të ndara sipas Veprimtarive Formuese

Bazuar në kritëret e përcaktuara të kreditëve për veprimtaritë formuese ne udhëzimin e Ministrise se Arsimit dhe Shkencesnr.15 date 4.4.2008 kemi ketë ndarje:

- Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm **(A)** në program zënë 23 kreditë nga rreth 32 qe përcakton udhezimi
- Veprimtari në disiplina të formimit karakterizues **(B)** në program zënë 62 kreditë nga rreth 90 kredite e përcaktuar ne udhezim
- Veprimtaritë në disiplina të Ngjashme dhe/ose intëgruese **(C)** në program zënë 19 kredite nga rreth 18 te përcaktuar ne udhezim
- Veprimtari në disiplina me zgjedhje **(D)** në program zënë 36 kreditë nga 12-14 e përcaktuar ne udhezim
- Njohuri të tjera formuese si plotësime në gjuhët e huaja, informatikë, stazh, apo praktika **(E)** në program zënë 19 kreditë nga rreth 18 e përcaktuar ne udhezim.

- Teza e Diplomës (F) ne program ze 5 kredite aq sa është ne udhezim
- ❖ Syllabus-et për çdo lëndë, pasqyrojnë këto elementë:
 - Emërtimi i lëndës/modulit
 - Viti/semestri kur zhvillohet lënda
 - Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
 - Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
 - Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetimin e lëndës
 - Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
 - Tëmat që do të trajtojnë lënda në formimin tëorik dhe praktik
 - Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
 - Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportët midis tyre
 - Format e vlerësimit të studentëve
 - Detyrimet e studentit për lëndën
 - Literaturë e detyruar dhe ajo ndihmëse

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kritëret	Përmbushja e standardeve
I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kreditë, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Kreditëve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e kreditëve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi bachelor në Financë Banke në anglisht ofrohet që nga viti akademik 2012-2013 pranë Departamentit të Financë Banke duke reflektuar ndryshimet e kalimit nga sistemi 4 vjeçar I studimeve në atë 3 vjeçar. Studimet organizohen në module dhe vlerësohen në kreditë, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe të Grumbullimit të Kreditëve (ECTS).</p> <p>Programi zhvillohet në përputhje me programin e licencuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.</p> <p>Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek programin Bachelor në Financë- Bankë me kohë të plotë është 60 kredite.</p>
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.	
<p>Kriteri 1 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p> <p>Kriteri 3 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën</p>	<p>Departamenti i Financë-Bankës dhe Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative, është njësitë kryesore ku Programi Bachelor në Financë-Banke bën pjesë. Në këtë kuadër të gjithë palët e interesuara mund të marrin informacionin e duhur për përmbajtjen e programit të studimit që ofrohet. Ky informacion përmban edhe listën e të gjitha lëndëve të detyruara dhe me zgjedhje për çdo</p>

mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;

Kriteri 4 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionët e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikatat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.

semestër, shoqëruar edhe me syllabusin e detajuar për çdo lëndë.

Syllabusi i detajuar i çdo lënde, i cili është i publikuar në faqen e internetit, përmban edhe ngarkesën mësimore, orët në auditor, orët në laborator, atëllje apo praktikë mësimore si dhe orët e studimit individual. Në faqen e internetit dhe në Guidën e Studentit shpjegohen në mënyrë të hollësishme edhe të gjitha rregullat në lidhje me frekuentimin, provimet, apelimet e notës si dhe të gjitha dispozitat që i interesojnë studentëve. Informacioni në fjalë mund të përfitohet gjithashtu nga sekretaria mësimore dhe sekretaria e Departamentit

Konkluzionët e GVJ:

Departamenti i Financë banke i Universitetit "Epoka" ofron programin e studimit në Bachelor në Financë Banke 3 vjeçar i cili ofrohet që nga viti akademik 2012-2013. Studimet në këtë program organizohen në module dhe vlerësohen në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe të Grumbullimit të Kreditëve (ECTS). Sasia mesatare e kreditëve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek programin Bachelor në Financë-Banke me kohë të plotë është 60 kreditë ECTS.

Departamenti i Financë-Banke dhe Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative, si njësi kryesore ku Programi Bachelor në Financë-Banke anglisht zhvillohet ofron informacionin e plotë të këtij programi për të interesuarit nëpërmjet faqes së internetit ku përfshihet; lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër, ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikatat, ushtrimet apo orët e laboratorit.

Rekomandime:

- ❖ Në program mendojmë se duhet të përfshihet edhe praktika profesionale e cila do të beje që të gjithë studentët të kenë mundësi ta realizojnë dhe të bëhen me të kërkuar në tregun e punës. Realizimi i deritanishëm nëpërmjet intërshipeve gjatë periudhës së verës nuk siguron realizimin e praktikës për të gjithë studentët.
- ❖ Megjithëse programi reflekton ndryshimet nga sistemi 4 vjeçar në sistemin 3 vjeçar mendojmë që duke qenë një program për ciklin e parë të studimeve të mund "të lehtësohej" nga zhvillimi i një programi të ngjeshur nëpërmjet marrjes së njohurive të karakterit shkencor. Kështu zhvillohen 2 lende të statistikes (Statistika 1 dhe statistika 2) si dhe dy lende të Ekonometrise . Zëvendësimi i të paktën një lende të ekonometrise në programin e ciklit të dytë do krijonte mundësi jo vetëm të lehtësimi të programit por edhe të përfshirjes së lendeve me profesionale të financë banke. Po ashtu programi është i ngarkuar me rreth 5 lende të fushës së marketingut (me detyrim dhe zgjedhje) në një kohe që mund të zëvendësohej me lenden e "Marketingut Bankar" si lende me profesionale. Edhe dy lendet që zhvillohen; Politika dhe Teoritë monetare 1 dhe 2 mendojmë se kanë kryesisht karakter tëorike shkencor dhe të paktën njëra prej tyre i takon programit të ciklit të dytë të studimeve.
- ❖ Sistëmi i vlerësimit të kreditëve duhet parë pasi nga programi rezultojnë që pothuajse të gjitha lendet kanë 5 ECTS.
- ❖ Në programin e vitit të parë mendojmë se duhet të përfshihet lënda e Makroekonomisë që është në vitin e dytë në vend të lendes Paraja dhe Banka që është në vitin e parë. Gjithashtu mendojmë se është e rëndësishme përfshirja që në vitin e parë të lendes "Hyrje në Financë" që aktualisht mungon por që do të pajisë studentët me njohuritë bazë në këtë disiplinë. Gjithashtu lënda "Ekonomia Ndërkombëtare" mund të zëvendësohet me lëndën "Financa Ndërkombëtare" e cila mungon por që është me përfaqësuese e këtij programi.

- ❖ *Nga dy lëndë që zhvillohen mbi legjislacionin, mendojmë se mund të zëvendësohet një prej tyre me lëndën legjislacioni financiar e bankar që mungon në mënyrë që studentët të marrin njohuritë baze në fushën e legjislacionit financiar e bankar.*
- ❖ *Megjithëse programi është në anglisht ai mund të lehtësohet nga shume lende në disa gjuhë të huaja (janë disa nivele të anglishtes, frengjishtes, gjermanishtes dhe turqishtës).*
- ❖ *Të shihet mundësia që studentët të zgjedhin lëndë të formimit karakteriuzues të programit në mënyrë që pesha e këtyre lëndëve të profesionit të zerë më shumë vend në program. Pra nga rreth 62 kredite që zenë aktualisht të rritet në 80-90 kredite. Kjo do të plotësonte edhe kriterin e udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës*

8. Mësimdhënia

Mësimdhënia në programin Bachelor në Financë Banke anglisht bazohet në Rregulloren e Studimeve Universitare dhe Provimeve e cila përcakton format e mësimdhënies dhe vlerësimin e dijeve të studentëve.

Provimet përgjithësisht janë mbajtur në formë të shkruar. Megjithatë, pedagogu i lëndës mund të vendosë për të kryer provimin në formën e një provimi me gojë, projekt ose detyrë kursi.

Vlerësimi i studentëve në Universitetin "Epoka" për rrjedhojë edhe ai në programin Financë Banke bëhet në bazë të sistemit amerikan të krediteve dhe ECTS-së, e llogaritur sipas metodologjisë së përcaktuar në Rregulloren e Studimeve të Ciklit të Parë dhe Provimeve në Universitetin "Epoka

Auditimi i brendshëm është kryer nga Grupi i Brendshëm i Auditimit cdo vit akademik. KVAPC ka të drejtë të ngrëjë nën komitete apo nëngrupe për t'u marrë me një aktivitet të veçantë në kuadër të të drejtave dhe përgjegjësi të caktuara të KVAPC.

- ❖ Llojet e Formave të mësimdhënies, të programit përfshijnë:
 - Leksionë ore totale në auditor 1846
 - Seminare ore totale në auditor 64
 - Ushtrime
 - Laboratorë
 - Praktikë lëndore
 - Praktikë profesionale
 - Etj
- ❖ Format e kontrollit të njohurive përfshijnë:
 - Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive Specifikuar në sylabuset përkatëse
 - Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit
 - Specifikuar në sylabuset përkatëse
 - Tëstimet gjatë vitit Specifikuar në sylabuset përkatëse
 - Provimi përfundimtar Specifikuar në sylabuset përkatëse
 - Etj; të specifikuar në sylabus
- Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Ne verifikuam që studentë të programit Bachelor në Financë Banke kanë marrë pjesë në evenimente të organizuara nga Departamenti i Financë Banke apo nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative. Aktivitete të tilla kanë përfshirë seminare, konkurse, samite apo forume të organizuara jashtë vendit.

9. Studentët

Nga takimet e ndryshme që realizoi GJV me studentët, me zyrën e karrierës me Dekanin, Pergjegjesin e departamentit na u theksua se Universiteti "Epoka" harton programin e Planifikimit të Karrierës. Ky program synon informimin e të gjithë maturantëve në qytete të ndryshme të vendit mbi programet që ofrohen, mundësitë e programit Erasmus, praktikat verore, konferencat, klubet studentore dhe bursat që në ofrojmë për nxënësit më të mirë.

Fillimisht Zyra e Pranimit pas informimit dhe pritjes se kandidatëve për student organizon zhvillimin e provimit të Anglishtës. Ky provim ka rezultuar shumë produktiv për maturantët pasi anglishtja ka qënë ndër provimet me detyrim në provimet e maturës shtetërore dhe nxënësve nëpërmjet këtij provimi u përcaktohet edhe niveli i Anglishtës që kanë.

Vitin e kaluar universiteti ka mirëpritur 2433 nxënës gjithsej nga 39 shkolla të mesme nga e gjithë Shqipëria Kosova edhe Maqedonia si pjesë e këtij programi.

Një rol promovues në këtë proces është edhe Panairi i Karrierës një aktivitet që synontë t'i ofrontë mundësi studentëve të vitit të fundit, dukë i orientuar dhe mbështetur në hapat e parë të një karriere të suksesshme.

Universiteti organizon edhe Forumet e Hapura të zhvilluara nga klubet studentore në të cilët janë të ftuar për të folur mbi temat më aktuale të shoqërisë njerëzve suksesshëm në fushat përkatëse.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kritëret	Përmbushja e standardeve
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.	
<p>Kriteri 1 Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktët nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Pranimi i studentëve të rinj në programet e ciklit të parë që ofrohen nga Universiteti "Epoka", GJV ju komunikua se bëhej sipas ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionët e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".</p> <p>Çdo shtetas i Republikës së Shqipërisë që ka përfunduar me sukses Maturën Shtetërore dhe që plotëson Kriterin e notës mesatare ka të drejtë të kandidojë për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve në Universitetin "Epoka".</p> <p>Çdo shtetas i Republikës së Shqipërisë që ka përfunduar me sukses studimet e shkollës parauniversitare jashtë Shqipërisë dhe disponon vërtëtimin e njësimit të kësaj diplome lëshuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit së Republikës së Shqipërisë dhe që plotëson Kriterin e notës mesatare ka të drejtë të kandidojë për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve në Universitetin "Epoka".</p> <p>Shtetasit e huaj, kuotat e të cilëve bëhen të ditur çdo vit, që kanë përfunduar me sukses studimet e shkollës parauniversitare jashtë Shqipërisë dhe disponojnë vërtëtimin e njësimit të kësaj</p>

diplome lëshuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit së Republikës së Shqipërisë dhe që plotëson Kriterin e notës mesatare si dhe disponojnë një nga certifikatat e njohjes së gjuhës angleze nga Ministria e Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë, kanë të drejtë të kandidojnë për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve në Universitetin "Epoka".

Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.

Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;

Kriteri 2 Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;

Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;

Kriteri 4 Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.

Gjatë vizitës në Institucion por edhe gjatë takimeve të GVJ me aktorët e ndryshëm na u cilësua se: Universiteti "Epoka" në kuadër të transparencës kundrejt studentëve dhe palëve të treta të interesuara jep në faqen e internetit të gjithë informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programeve të studimit që ofron, mënyrën e organizimit të tyre si dhe kohëzgjatjen programeve të studimit. Në fillim të çdo viti akademik institucioni pajis çdo student me Udhëzuesin (Guidën) e Studentit e cila përmban informacionin e nevojshëm për jetën studentore. Në javën e parë të vitit akademik institucioni zhvillon javën e orientimit ku studentët janë të detyruar të ndjekin katër seksionë gjatë të cilave informohen në mënyrë të detajuar. Në kuadrin e krijimit të sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë në Universitetin "Epoka", ka një praktike pozitive të vlerësimit të punës së stafit akademik nga ana e studentëve në fund të çdo semestri përmes plotësimit të një anketë, të përbërë nga kategori të veçanta për vlerësimin e pedagogut, vlerësimin e lëndës, si edhe kënaqësisë së përgjithshme të studentëve për lëndën e dhënë nga pedagogu përkatës. Studentët mund të shprehin kënaqësinë ose pakënaqësinë e tyre në lidhje me kategoritë përkatëse duke ruajtur fshehtësinë e plotë.

Përgjigjet e marra nga studentët janë analizuar dhe janë marrë, gjithashtu edhe rezultatet përkatëse. Rezultatet e performancës janë shpërndarë nga rektori për pedagogët në fjalë dhe për përgjegjësit e departamentëve përkatëse.

Fshehtësia e informacionit është e mbrojtur në të gjitha fazat e nxjerrjes së rezultatëve, në shpërndarjen e vkorrespondencës në njësitë në fjalë, personat, si edhe në arkivimin e tij. Rezultatet e anketave të vlerësimit të

pedagogëve dhe të lëndës sigurojnë të dhëna të rëndësishme sasiore dhe janë marrë në konsideratë në lidhje me rinovimin e kontratave me stafin akademik, si edhe në caktimin e personelit në lëndët përkatëse.

Universiteti “Epoka” u ofron studentëve dhe të diplomuarve të sajë shërbimin e këshillimit të karrierës nëpërmjet “Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe e Studentëve të Diplomuar

Kjo Zyrë u ofron studentëve mundësinë e kryerjes së praktikave profesionale në kompani të ndryshme. Ajo organizon Panairin e punësimit në muajin prill të çdo viti, ku në çdo panair marrin pjesë rreth 50 kompani të cilat operojnë në tregun vendas. Përfaqësuesit e kompanive marrin në intervista punësimi studentët të cilët ndodhen në vitin e fundit dhe pas 1 muaji do të dalin në tregun e punës. Nga rezultatet e vitëve të kaluara rezultojnë që një pjesë e studentëve përfitojnë vende pune dhe ka student që përfitojnë praktikë në këto kompani me qëllimin për tu punësuar në bazë të performancës që studentët do të kenë përgjatë periudhës së praktikës

Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.

Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;

Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;

Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.

Sekretaria mësimore e Universitetit “Epoka” disponon statistika të detajuara vjetore për numrin e të diplomuarve për çdo program dhe cikël studimi në bazë viti akademik. Njëkohësisht, Universiteti “Epoka” ka ngritur Zyrën Alumni e cila përditëson të dhënat në lidhje me studentët e diplomuar dhe siguron mbajtjen e lidhjeve të vazhdueshme ndërmjet të diplomuarve dhe Universitetit.

Sekretaria Mësimore e Universitetit “Epoka” disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar gjatë vitëve akademike në programet e studimeve të të gjitha cikleve në përputhje me të gjitha udhëzimet, disponon statistika dhe informacion për tërheqjet nga programi të studentëve duke u bazuar në kërkesat e tyre, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik Sekretaria Mësimore e Universitetit “Epoka” si dhe sekretaritë e departamenteve ndjekin hap pas hapi të gjithë procesin mësimor si dhe disponojnë të gjithë informacionin e nevojshëm dhe të

dhënat përkatëse për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim, duke përfshirë vlerësimin dhe notat në provime, frekuentimin në kurset që zhvillohen, kërkesat e ndryshme të studentëve, masat disiplinore etj.

Standardi IV.4 Institucioni angazhon personëlin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.

Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;

Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.

Zyra e Dekanatit të Studentëve, nëpërmjet “Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe e Studentëve të Diplomuar” ndjek progresin e studentëve në procesin mësimor. Në këtë kuadër kjo zyrë ofron programin e “Mentorimit”. Duke ofruar këtë program studentët në nevojë marrin leksionë nga studentët më të mëdhenj të cilët janë përfitues të programit të bursave në universitetin “Epoka”, u vijnë në ndihmë studentëve në fjalë në lëndë përkatëse. Ky program organizohet në periudhë semestrale. Në çdo semestër 40-50 studentë përfitojnë nga programi i Mentorimit. “Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe e Studentëve të Diplomuar” në fillim të çdo semestri hap aplikimet për studentët në nevojë gjithashtu edhe për studentët të cilët duan të bëhen mentor në ndonjë lëndë të caktuar, dhe më pas bëhet ndërlihdja midis mentorit dhe studentit në nevojë.

Si pjesë e strategjisë së “Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe e Studentëve të Diplomuar” janë edhe praktikat profesionale. Praktikrat përgjithësisht realizohen gjatë muajve të verës dhe janë me kohë të plotë. Çdo vit në muajin mars, hapen aplikimet pranë “Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe e Studentëve të Diplomuar. Në vitet e fundit ka patur një interes në rritje të studentëve të cilët aplikojnë në programet e praktikave profesionale.

Konkluzionët e GVJ

Pranimi i studentëve të rinj në programin Bachelor në Financë Bankë bëhet sipas ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionët e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Universiteti “Epoka” aplikon edhe kriteret shtesë në lidhje me pranimin e studentëve të rinj në programin Bachelor në Financë Bankë.

Studentët në programin Bachelor në Financë Bankë informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit që ndjekin, mënyrën e organizimit dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve nëpërmjet javës së orientimit në fillim të vitit akademik, Guidës së Studentit, si edhe informacionit të publikuar në faqen zyrtare të Universitetit “Epoka”.

Në kuadër të krijimit të sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë në Universitetin “Epoka”, e gjithë puna e stafit akademik vlerësohet nga ana e studentëve në fund të çdo semestri përmes plotësimit të një anketë, të përbërë nga kategori të veçanta për vlerësimin e pedagogut, vlerësimin e lëndës, si edhe kënaqësisë së përgjithshme të studentëve për

lëndën e dhënë nga pedagogu përkatës. Studentët mund të shprehin kënaqësinë ose pakënaqësinë e tyre në lidhje me kategoritë përkatëse duke ruajtur fshehtësinë e plotë. Universiteti "Epoka" i ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës nëpërmjet strukturave të organizuara.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Universiteti "Epoka" është i mirëorientuar drejt kërkimit shkencor. Universiteti inkurajon të gjithë anëtarët e stafit akademik për të qenë aktivë në fushën kërkimore, duke ofruar mbështetje financiare. Në përfundim të çdo viti akademik, të gjitha publikimet shkencore të botuara nga ana e stafit akademik vlerësohen nga një juri e posaçme në bazë të kritereve të përcaktuara në "Rregulloren për Nxitjen e Publikimeve Shkencore" të Universitetit, duke u mbështetur në kritëret përkatëse. Çdo vit, Bordi Administrativ i Universitetit vendos masën e shpërblimit për çdo pikë të fituar dhe në bazë të pikëve të mbledhura, çdo anëtar i stafit akademik përfiton shpërblimin përkatës.

Universiteti "Epoka" ofron gjithashtu mbështetje financiare për pjesëmarrjen e stafit akademik në konferenca dhe veprimtari shkencore, të organizuara brenda dhe jashtë vendit. Si rregull, çdo anëtar i stafit akademik ka të drejtë të përfitojë një herë në vit mbështetje financiare për pjesëmarrje në këto veprimtari.

Në të njëjtën kohë, organizimi ose bashkëorganizimi i konferencave dhe i veprimtarive shkencore të një niveli ndërkombëtar është një tjetër dimension i rëndësishëm i politikës kërkimore të Universitetit "Epoka".

Informacion për ndërlidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien

Duke pasur parasysh lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien, në programet e ciklit të parë, studentët janë nxitur vazhdimisht të ndërmarrin kërkime shkencore. Rezultati është botimi i artikujve nga ana e studentëve si dhe pjesëmarrja e tyre në konferenca të ndryshme.

Një pjesë e mirë e stafit akademik ka marrë pjesë në konferenca dhe veprimtari të ndryshme shkencore brenda dhe jashtë vendit. Njëkohësisht, Universiteti "Epoka" ka organizuar gjashtë konferenca shkencore ndërkombëtare.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Që nga themelimi i Universitetit, i është vënë rëndësi zbatimit të dijeve të përftuara gjatë procesit të mësimdhënies, që do t'u mundësojë studentëve të krijojnë lidhje me kërkesat e tregut vendas të punës, duke filluar nga studimet e tyre universitare. Në këtë drejtim, rëndësi e veçantë i është dhënë organizimit të praktikave për studentët në institucionë të ndryshme publike, si dhe në kompani privatë si brenda dhe jashtë Shqipërisë, kryesisht gjatë sezonit të verës.

Gjatë vitit të kaluar akademik, rreth 30% e komunitetit të studentëve ka marrë pjesë në praktika të organizuar nga Universiteti. Studentët kanë zhvilluar praktikat verore përveç Shqipërisë edhe në Turqi, Kosovë dhe Greqi.

Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare (IRO) kryen funksionin e saj nën varësinë e Rektoratit në Universitetin "Epoka". Funksioni i saj kryesorë është zhvillimi dhe zbatimi i politikave ndërkombëtare dhe promovimi i procesit të ndërkombëtarizimit të Universitetit.

Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare nxit dhe siguron matërializimin e politikave ndërkombëtare të Universitetit në përputhje me objektivat dhe udhëzimet të vendosura nga Rektoratit në konsultim me partnerët e fakultetëve përkatëse.

Në kuadër të qëllimeve të qëllimeve të sipërpërmendura, Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare realizon kordinimin e marrëdhënieve me institucionët e tjera, prezantimin dhe promovimin e Universitetit në arenën ndërkombëtare dhe promovon imazhin

ndërkombëtar si një qendër globale e përsosmërisë në mësimdhënie dhe në aktivitetët kërkimore.

Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare mbart si mision krijimin e të gjitha kushteve të nevojshme për promovimin dhe intensifikimin e ndërkombëtarizimit të Universitetit “Epoka”.

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar
 - Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projektë Kombëtare apo ndërkombëtare
 - 2 Projektë kërkimore ndërkombëtare
 - 9 Projektë kërkimore shkencore të brendshme
 - Numri i Leksionëve dhe seminareve me lektorë të huaj
 - Për vitin akademik 2013-2014: 16 lektorë të huaj
 - Për vitin akademik 2014-2015: 4 lektorë të huaj
 - Për vitin akademik 2015-2016: 13 lektorë të huaj
 - Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL
 - Për vitin akademik 2012-2013:** 5 student nga IAL dhe 0 studentë drejt IAL
 - Për vitin akademik 2013-2014:** 4 studentë nga IAL dhe 1 studentë drejt IAL
 - Për vitin akademik 2014-2015:** 5 studentë nga IAL dhe 0 studentë drejt IAL
 - Për vitin akademik 2015-2016:** 0 studentë nga IAL dhe 0 studentë drejt IAL
 - Numri i pjesëmarrësve në aktivitetë shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime 46
- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionët e tjera universitare 36
- Programe bashkëpunimi në kuadër të programit ERASMUS 6
- Anëtarësime në organizata të tjera 8
- Studentë të dërguar në kuadër të shkëmbimeve universitare 13
- Pjesëmarrës në projektë nderkombetare 6

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kritëret	Përbushja e standardeve
VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME	
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personëlit të vet.	
Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personëlit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit; Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personëlit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të	Universiteti “Epoka” nxit frymën e bashkëpunimit ndërmjet stafit të universitetit duke i inkurajuar ata që të bëhen pjesë e projekteve të ndryshme ose të bëjnë kërkime shkencore në bashkëpunim me njëri tjetrin. Shkëmbimi i informacionit ndërmjet stafit të Departamentit bëhet në rrugë shkresore, me e-mail, në mënyrë verbale si dhe nëpërmjet

punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.

mbledhjeve periodike që zhvillohen nga ana e Departamentit.

Kompetencat dhe ndarja e detyrave të personelit janë parashikuar në Rregulloren e Organizimit Administrativ, e cila mundëson marrjen e përgjegjësive përkatëse dhe analizën e vazhdueshme të punës së tyre si dhe garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.

Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionët homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.

Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionët homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;

Kriteri 2 Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;

Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtëjshme në bashkërendim me punëdhënësit;

Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.

Universiteti "Epoka" ndjek një strategji të hapur për bashkëpunim dhe partneritet në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar për realizimin e misionit dhe të qëllimit të tij. Me institucionët e huaja arsimore që ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, Universiteti "Epoka", ndjek një politikë favorizuese për lëvizshmërinë e personelit akademik dhe të studentëve, për organizimin e përbashkët të konferencave ndërkombëtare dhe projekteve të përbashkëta kërkimore dhe trajnime profesionale e stazhe studentore.

Universiteti "Epoka" u kushton rëndësi të veçantë praktikave profesionale. Prandaj, veçanërisht gjatë verës, studentët nxitën dhe iu ofrohet mundësia të ndjekin praktika mësimore në formë stazhi.

Universiteti "Epoka" ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve. Për këtë arsye, janë nënshkruar memorandume Bashkëpunimi me institucione të ndryshme brënda dhe jashtë vendit. Sipas këtyre marrëveshjeve, studentët e Universiteti "Epoka" përfitojnë nga mundësitë e praktikave të ofruara nga këto kompani.

Universiteti "Epoka", prej një periudhe 5-vjeçare i jep mundësinë studentëve dhe stafit akademik të marrin pjesë në programet e shkëmbimit në kuadrin e Marrëveshjeve Dypalëshe, Programit të Shkëmbimit Mevlana dhe Programit të Shkëmbimit Erasmus+.

Universiteti "Epoka", numëron 31 marrëveshje dypalëshe me universitetë të ndryshme në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjermani, Itali, Spanjë, Estoni, Zvicër, Rumani, Poloni, Turqi etj. Nëpërmjet marrëveshjeve të lartpërmendura, Universiteti ka mundësuar shkëmbimin e 65 studentëve të cilët kanë

kryer një ose dy semestra në njërin nga universitetet partnere

Konkluzionet e GVJ

Universiteti "Epoka" nxit frymën e bashkëpunimit ndërmjet stafit të universitetit duke i inkurajuar ata që të bëhen pjesë e projektëve të ndryshme ose të bëjnë kërkime shkencore në bashkëpunim me njëri tjetrin. Universiteti "Epoka" ndjek një strategji të hapur për bashkëpunim dhe partneritet në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar për realizimin e misionit dhe të qëllimit të tij. Me institucionet e huaja arsimore që ka nënshkruar

marrëveshje bashkëpunimi, Universiteti "Epoka" ndjek një politikë favorizuese për lëvizshmërinë e personelit akademik dhe të studentëve, për organizimin e përbashkët të konferencave ndërkombëtare dhe projekteve të përbashkëta kërkimore dhe trajnime profesionale e stazhe studentore.
GVJ konstaton se programi në fjalë i përmbush kriteret e kërkuara.

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Bazuar në raportin e vlerësimit të Brendshëm dhe evidentimin në vend konkludojme se programi Bachelor në Financë Banke reflekton plotësimin relativisht të plotë të rekomandimeve nga akreditimi i parë.

II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

Nga analizat e kryera dhe të paraqitura në raportin e vlerësimit të brendshëm, nga vizitat e kryera në vend në ambientët e UE dhe nga të dhënat e grumbullura drejtpërdrejtë dhe nëpërmjet anketimit të studentëve, arrijmë në disa konkluzionë të rëndësishme:

Programi Bachelor në Financë Banke anglisht është ndërtuar duke respektuar jo vetëm ligjërisht por në praktikë kërkesat ligjore dhe kërkesat që burojnë nga misioni dhe objektivat e programit. Të gjithë elementët e programit duke filluar që me planin mësimor, mësimdhënien, stafin akademik, kërkimin shkencor dhe infrastrukturën janë në nivele të mira dhe optimale dhe japin garanci për realizimin etij.

Analiza SËOT e paraqitur në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë është objektive, realistë dhe qëndron në bazë të përcaktimit të piketave themelore të planit strategjik të zhvillimit të institucionit, i cili është gjithashtu pjesë e atij Raporti. Pa përsëritur dhe komentuar të gjithë analizën SËOT të evidentuara në Raport, të cilat mendojmë se janë të argumentuara, po qëndrojmë në disa prej tyre.

a. Pika të forta:

1. Program studimi Bachelor në Financë Banke në anglisht me kohëzgjatja prej 3 vitësh, i përshtatur me kontëkstin shqiptar e cila i jep përparësi këtij programi duke bërë diferencën me shumicën e universitetëve të tjera ku mungon një program bachelor në anglisht.
2. Kushtë shumë të mira mjedisore dhe infrastrukturore që përfshinë vendosjen e kampusit në kryeqytët, ndërtimin e përfunduar të kampusit modern, i japin një përparësi këtij programi.

3. Dokumentacioni ligjor dhe pedagogjik cilësor që shoqëron këtë program
4. Plani mësimor dhe programe bashkëkohore në të gjithë elementët e tij.
5. Ndërtimi i një sistemi të plotë dhe efektiv të informacionit bazuar në një investim të konsiderueshëm
6. Ekzistenca e një sistemi të brendshëm të mirë vlerësimi të institucionalizuar
7. Përpjekjet sistematike për të zbatuar standardet në mësimdhënie dhe në kontrollin e dijeve dhe për të shmangur plagjiaturën në punimet e studentëve.
8. Procesi i përzgjedhjes për regjistrimin e studentëve
9. Ofrimi i bursave të pjesshme dhe të plota për të tërhequr studentë të suksesshëm
10. Përdorimi i literaturës bashkëkohore të autorëve dhe i burimeve të tjera të botuara.

b. Pika të dobëta:

1. Pësia relativisht e lartë e stafit akademik pa grade shkencore dhe numri minimali lejuar i PAE të Departamentit Financë Banke.
2. Praktika mësimore jo të detyrueshme
3. Raport i lartë në numër student –profesorë
4. Mungesa e njohjes së gjuhës shqipe nga një pjesë e stafit të huaj

c. Mundësitë:

1. Zgjerim i tregut rajonal, jo vetëm shqipfolës, por edhe kombësi të tjera përfshirë
2. Zgjerimi i bashkëpunimeve brenda dhe jashtë vendit në drejtim të shkëmbimit të stafit akademik dhe studentëve
3. Zgjerimi i PAE të departamentit të Financë banke me shume staf me grada shkencore për ti paraprirë jo vetëm përfshirjes në program të lendeve të kësaj fushe por dhe rritjes se ngarkesës mësimore rrjedhoje e rritjes se numrit të studentëve edhe në ciklet e tjera të studimit.
4. Rritja e numrit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitetët dhe institucionët e tjera

d. Pengesat:

1. Rritja e konkurrencës në arsimin e lartë në nivel lokal, rajonal dhe më gjerë

Ekspert i vlerësimit të jashtëm:

Prof. Dr. Drini Salko

Tiranë Korrik 2017

ANËKSI 1

Tabela 1: Numri i Personëlit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK)

Fakultëti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative	Departamenti Finance Banke						Departamenti 2			
	Numri i PAE		Numri i PAK		Në Total				
	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada				
	8	3	9	4	17	7				

ANËKSI 2

Tabela 2: Lista e Personëlit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK)

Fakultëti Shkencave Ekonomike dhe Administrative. Departamenti Finance Banke							
Personëli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)	Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personëli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time	
1	Ugur Ergun	Përgjegjës i Departamentit	Prof.As	1	Lindita Mukli	Prof.As	Universiteti "Aleksandër
2	Abdulmenaf Sejdini	Lektor	Dr.	2	Juliana Imeraj	Dr.	Universiteti "Aleksandër Moisiu"
3	Urmat Ryskulov	Lektor	Dr.	3	Albana Demi	Dr.	Universiteti "CIT"
4	Erinda Imeraj.	Asistent Lektor	M.Sc	4	Arben Zibri	Dr	Dhoma Amerikane e Tregtisë
5	Mergleda Hodo.	Asistent Lektor	M.Sc	5	Kristal Hykaj	M.Sc.	Ministria e Financave
6	Jonada Tafa.	Asistent Lektor	M.Sc	6	Avenir Lleshanaku	M.Sc	Banka Kombëtare Tregtare
7	Ditmir Sufaj.	Asistent Lektor	M.Sc.	7	Ilirjana Kraja	M.Sc	Instituti i Statistikave
8	Bora Kokalari	Ndihmës Akademik	B.Sc.	8	Erda Cani	M.Sc	Agjensia e Mbikqyrjes Financiare
				9	Idaver Sherifi	M.Sc.	Person fizik

ANËKSI 3

Tabela 3: Të dhënat e stafit akademik sipas kualifikimit dhe Raportët midis tyre

Titulli	Departamenti i Finance banke		
	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK
Profesorë	=	=	=
Profesorë të As.	1	1	1
Doktorë	2	3	0.67
Docentë	==	=	
Pedagogë (pa tituj)	3	3	0.67
Asistëntë me Ma	1	2	0.5
Asistëntë pa Ma			

Aneksi 4,5,6 janë njësoj me anekset përkatëse të programit Bsc financë bankë shqip

ANEKSI 4

Tabela 4: Të dhëna për anëtarët e NJSBC

	Anëtarët e NJSBC	Detyra që ka në në NJSBC	Sa kohë ka në këtë detyrë
1	Dr. Islam Jusufi	Kryetar	16.03.2016 - në vazhdim
2	Assist. Prof. Dr. Arban Uka	Zëvendës Kryetar	16.03.2016 - në vazhdim
3	Dr. Reina Shehi	Anëtar	16.03.2016 - në vazhdim
4	Z. Loren Senja	Anëtar	16.03.2016 - në vazhdim
5	Z. Arjan Shahini	Anëtar i Jashtëm	16.03.2016 - në vazhdim
6	Z. Altin Bora	Anëtar (Raportues)	11.01.2017 - në vazhdim
7	Z. Idaver Sherifi	Anëtar (i diplomuar)	16.03.2016 - në vazhdim
8	Z. Redion Spaho	Anëtar (Kryetar i Këshillit Studentor)	19.01.2017 - në vazhdim

ANEKSI 5

Tabela 5: Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Lëndë/Module	Semestri	ECTS	Orë mësimore													Gjithsej	Provime		
			Leksione			Seminare			Laborator			Praktikë							
			ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	Punë e Pavarur	Orë në auditor			Punë e Pavarur	
1	Sistemet Informatike (Ishte)	I	5	5	32	45				5	16	32				48	77	125	2
	Zhvillimi i Aftësi në Shkrim dhe Lexim në Anglisht (u ndryshua)		5	5	64	61										64	61	125	2
2	Sociologji (Ishte)	II	5	5	48	77										48	77	125	2

	Manaxhimi dhe Organizmi (u ndryshua)	II	5	5	48	77													48	77	125	2
3	Aftesite komunikuese (Ishte)	II	5	5	48	77													48	77	125	2
	Paraja dhe Banka (u ndryshua)	II	5	5	48	77													48	77	125	2
4	Mikroekonomi II (Ishte)	III	5	5	48	77													48	77	125	2
	Bazat e Financës së Korporatave (u ndryshua)	III	5	5	48	77													48	77	125	2
5	Ekonomi pune (Ishte)	III	5	5	48	77													48	77	125	2
	Me zgjedhje(gjuhe e huaj) (u ndryshua)	III	5	5	48	77													48	77	125	2
6	Makroekonomi II (Ishte)2	IV	5	5	48	77													48	77	125	2
	Me zgjedhje(gjuhe e huaj) (u ndryshua)	IV	5	5	48	77													48	77	125	2
7	Parimet bankare (Ishte)	V	5	5	48	77													48	77	125	2
	Krahasimi i Sistemit Bankar (u ndryshua)	V	5	5	48	77													48	77	125	2
8	Politika dhe teoria monetare (Ishte)	V	5	5	48	77													48	77	125	2
	Lende me Zgjedhje III (u ndryshua)	V	5	5	48	77													48	77	125	2
9	Bazat e Financës së Korporatave (Ishte)	VI	5	5	48	77													48	77	125	2
	Ekonometri Financiare I (u ndryshua)		5	5	64	61													64	61	125	2
10	Menaxh financiar (Ishte)	VI	5	5	64	61													64	61	125	2
	Ekonometri Financiare II (u ndryshua)	VI	6	6	64	86													64	86	150	2
Shenim: Ka levizje te lendes Bazat e Financës së Korporatave nga semestri VI ne të III, ndaj ne rezultatin total te kurrikulës janë 9 ndryshime																						
Ndryshime në Total: 9																						

ANEKSI 6

Tabela 6: Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Lënda / Moduli	Pedagogu /ët përgjegjës	Titulli/grada kualifikimi	Departamenti	Statusi PAE apo PAK
1. Hyrje në Ekonomi I	Erinda Imeraj	M. Sc.	BAF	PAE
2. Hyrje në Biznes	Idaver Sherifi	M. Sc.	BAF	PAK
3. Hyrje në Legjislacion	Eglantina Farruku	M. Sc.	ECO	PAE
4. Shkencat e Sjelljes	Besjon Zenelaj	M. Sc.	PIR	PAE
5. Mat. Për Ekonominë dhe Biznesin I	Lindita Mukli	Assoc. Prof. Dr.	BAF	PAK

6.	Zhvillimi i Aftësive në Shkrim dhe Lexim në Anglisht	Mirela Alhasani	M.A	ECO	PAE
7.	Hyrje në Ekonomi II	Areta Dymleku	M. Sc.	ECO	PAK
8.	Hyrje në Kontabilitet	Albana Demi	Dr.	BAF	PAK
9.	Manaxhimi dhe Organizmi	Idaver Sherifi	M. Sc.	BAF	PAK
10.	Paraja dhe Banka	Erda Cani	M. Sc.	BAF	PAK
11.	Mat. Për Ekonominë dhe Biznesin II	Lindita Mukli	Assoc. Prof. Dr.	BAF	PAK
12.	Anglisht Biznesi	Mirela Alhasani	M.A	ECO	PAE
13.	Kontabilitet Financiar I	Albana Demi	Dr.	BAF	PAK
14.	Statistikë I	Lindita Mukli	Assoc. Prof. Dr.	BAF	PAK
15.	Mikroekonomi	Eglantina Hysa	Assoc. Prof. Dr.	ECO	PAE
16.	Legjislacioni i Biznesit	Eglantina Farruku	M. Sc.	ECO	PAE
17.	Bazat e Financës së Korporatave	Kristal Hykaj	M. Sc.	BAF	PAK
18.	Turqisht I	Sadullah Yilmaz	M.A	PIR	PAE
19.	Frëngjisht I	Eglantina Gishti	M. Sc.	PIR	PAK
20.	Gjermanisht	Arjan Shahini	M. Sc.	PIR	PAK
21.	Statistikë II	Lindita Mukli	Assoc. Prof. Dr.	BAF	PAK
22.	Kontabilitet Financiar II	Albana Demi	Dr.	BAF	PAK
23.	Financë Publike	Kristal Hykaj	M. Sc.	BAF	PAK
24.	Manaxhim Financiar	Indrit Beqaraj		BAF	PAK
25.	Makroekonomi	Ola Çami	M. Sc.	ECO	PAK
26.	Frëngjisht I	Eglantina Gishti	M. Sc.	BAF	PAK
27.	Turqisht II	Sadullah Yilmaz	M.A	PIR	PAE
28.	Frëngjisht II	Eglantina Gishti	M. Sc.	PIR	PAK
29.	Institucionet dhe Tregjet Financiare	Erinda Imeraj	M. Sc.	BAF	PAE
30.	Ekonometri Financiare I	Ilirjana Kraja	M. Sc.	BAF	PAK
31.	Krahasimi i Sistemit Bankar	Erda Cani	M. Sc.	BAF	PAK
32.	Veprimet dhe Sherbimet Bankare	Avenir Lleshanaku	M. Sc.	BAF	PAK
33.	Politika dhe Teoria Monetare I	Abdulmenaf Sejdini	Assist. Prof. Dr.	BAF	PAE
34.	Turqisht III	Sadullah Yilmaz	M.A	PIR	PAE
35.	Manaxhim dhe Analize Kredie	Indrit Beqaraj		BAF	PAK
36.	Raportim dhe Kontabilitet Bankar	Avenir Lleshanaku	M. Sc.	BAF	PAK
37.	Ekonometri Financiare II	Ilirjana Kraja	M. Sc.	BAF	PAK
38.	Teza e Diplomes			BAF	PAE
39.	Politika dhe Teoria Monetare II	Arjeta Abazi	Assoc. Prof. Dr.	BAF	PAK